



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

THIRRJE PËR BASHKËPUNTORË

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), hap thirrjen për bashkëpunëtorë të jashtëm, të cilët do të angazhohen me qëllim përmbushjen e detyrave, objektivave dhe misionin e saj ligjorë në sistemin arsimor parauniversitar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

1. Të jetë punonjës në institucionet arsimore/ ekspert në fushën e arsimit.
2. Të ketë mbaruar arsimin e lartë me kohë të plotë në ciklin/profilin përkatës të lëndës.
3. Të ketë eksperiencë pune të paktën 5 vjet në mësimdhënie dhe të ketë shkallën e tretë të kualifikimit “Mësues i kualifikuar”.
4. Të ketë vlerësimin “Shumë mirë”ose “Shkëlqyeshëm” në kualifikimin përkatës.
5. Të ketë zhvilluar lëndën përkatëse të paktën 1 (një) herë në të gjitha klasat e nivelit arsimor.
6. Të ketë njohuri dhe aftësi të mira në fushën e metodologjisë dhe vlerësimit.
7. Të ketë aftësi të mira në fushën e TIK.
8. Të ketë marrë pjesë në trajnime për zhvillim e tij profesional.
9. Kanë përparësi aplikuesit që kanë përvojë në zhvillimin e trajnimeve në fushën e metodologjisë, vlerësimit dhe TIK.
10. Kanë përparësi aplikuesit që kanë përvojë në hartimin dhe në vlerësimin e testeve në nivele të ndryshme arsimore.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Jetëshkrimi (CV-ja).
2. Vërtetim pune.
3. Fotokopje e diplomës së institucionit të arsimit të lartë.
4. Certifikata e kualifikimit.
5. Certifikata trajnimi/ dëshmi që tregojnë aftësitë në fushën e metodologjisë, vlerësimit dhe TIK-ut të përfituara gjatë tri viteve të fundit

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen me postë pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) me adresë:
Rruga Naim Frashëri, Nr.37, Tiranë

Afati i dorëzimit të dokumenteve është 01 tetor – 30 tetor 2021.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar do të shpallë listën e fituesve në faqen zyrtare, pas vlerësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga secili aplikant.

Faleminderit!